

ARCHIMED INTERNATIONAL sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E PERFORMANCËS	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	5 – 18

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2020

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	3,234,489	1,515,733
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	22,683,102	28,066,540
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	87,915,144	100,180,869
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	784,176	290,548
Inventarë	8	864,655	5,314,927
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	6,814,474	3,337,467
Totali i aktiveve afatshkurtra		122,296,040	138,706,084
Aktivët afatgjatë			
Aktive financiare	10	280,000	-
Aktive afatgjatë materiale	11	7,890,572	8,111,186
Totali i aktiveve afatgjatë		8,170,572	8,111,186
Totali i aktiveve		130,466,612	146,817,270
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	12	2,470,045	15,288,563
Parapagime të arketuara	13	-	1,227,041
Detyrime tatimore	14	632,661	1,139,435
Detyrime për qera financiare	15	2,265,750	2,978,435
Të tjera detyrime	16	1,328,495	1,357,980
Totali i detyrimeve afatshkurtra		6,696,951	21,991,454
Detyrime afatgjatë			
Totali i detyrimeve afatgjatë		-	-
Totali i detyrimeve		6,696,951	21,991,454
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar	17	100,000	100,000
Rezerva statutore		332,932	332,932
Rezerva ligjore		590,532	590,532
Rezerva të tjera		930,864	930,864
Fitime të mbartura		121,132,408	122,560,321
Fitimi i ushtrimit		682,925	311,167
Totali i kapitalit		123,769,661	124,825,816
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		130,466,612	146,817,270

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënime shpjeguese nga faqja 5 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ARCHIMED INTERNATIONAL sh.p.k.

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	69,005,097	105,054,691
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	19	18,208	842,119
Total të ardhura		69,023,305	105,896,810
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(51,711,511)	(82,393,266)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme	20	(24,219,377)	(19,023,907)
2) Të tjera shpenzime	21	(27,492,134)	(63,369,359)
Shpenzime të personelit	22	(15,412,350)	(21,718,222)
1) Paga dhe shpërblime		(13,253,174)	(18,725,741)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(2,159,176)	(2,992,481)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	23	(342,176)	(453,381)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	24	(551,251)	(84,922)
Shpenzime financiare	25	(105,296)	(133,608)
2) Shpenzime të tjera financiare		(105,296)	(133,608)
Fitimi/humbja para tatimit		900,721	1,113,411
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	26	(217,796)	(802,244)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(217,796)	(802,244)
Fitimi/humbja e vitit		682,925	311,167
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin			
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin			
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		682,925	311,167

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ARCHIMED INTERNATIONAL sh.p.k.

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva tjera	Fitimet e Pashpërdara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2019	100,000	590,532	332,932	930,864	116,922,620	5,637,701	124,514,649
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-	-	-	-	-	-
Fitim / Humbja e vitit	-	-	-	-	-	311,167	311,167
Dividendë të paguar	-	-	-	-	-	-	-
Transferim në fitime të mbartura	-	-	-	-	5,637,701	(5,637,701)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	100,000	590,532	332,932	930,864	122,560,321	311,167	124,825,816
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-	-	-	-	-	-
Fitim / Humbja e vitit	-	-	-	-	-	682,925	682,925
Dividendë të paguar	-	-	-	-	(1,739,080)	-	(1,739,080)
Transferim në fitime të mbartura	-	-	-	-	311,167	(311,167)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	100,000	590,532	332,932	930,864	121,132,408	682,925	123,769,661

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë aprovuar nga administratori i Archimed International sh.p.k më _____ Mars 2021 dhe janë firmosur si më poshtë.

Ardian Asllani
Ardian Asllani
Administrator



Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	682,925	311,167
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	342,176	453,381
Shpenzimet nga kembimet valutore	(1,135)	22,757
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	(806,365)
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	16,875,535	2,459,930
Rënie/(rritje) në inventarë	4,450,272	(4,672,143)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(13,354,777)	(37,942)
Rënie/(rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	(3,477,007)	3,012,900
Rritje/(rënie) në parapagime të arkëtuara	(1,227,041)	(3,565,460)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	-	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	4,290,948	(2,821,775)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(121,562)	105,719
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	1,000,000
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(121,562)	1,105,719
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare	(712,685)	(724,165)
Dividendë të paguar	(1,739,080)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(2,451,765)	(724,165)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	1,717,621	(2,651,659)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	1,515,733	4,190,149
Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të tjera monetare	1,135	(22,757)
Mjetet monetare në fund të periudhës	4	1,515,733

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

"Archimed International" sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 30 Tetor 1996 në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Mbi Shoqëritë tregtare".

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 Lek (njëqind mijë Lek), i cili zotërohet nga ortakut i saj i vetëm: Ardian Asllani.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është në fushën e ndertimit.

Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet në Rrugen "URANI PANO", Ndërtesa .5, H8/1, AP nr.19 Tiranë.

Në 31 dhjetor 2020 shoqëria ka 24 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, datë 10 maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, manaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, (zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, etj..) dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

(Vlerat janë në Lek)

3. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Euro/LEK	123.70	121.77
USD/ LEK	100.84	108.64

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë për llogaritë mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivët financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiarë vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerrret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivët financiarë të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivët afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundur që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Instalime teknike, makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	20%
Mobilje dhe pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka qira operative dhe qira financiare.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshem (apo të rikuperueshem) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabel të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

ARCHIMED INTERNATIONAL sh.p.k.
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
 (Vlerat janë në Lek)

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete monetare në banke	2,273,703	567,997
Në Lekë	205,810	104,669
Në monedhë	2,067,893	463,328
Mjete monetare në arkë	960,786	947,736
	<u>3,234,489</u>	<u>1,515,733</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Kliente për mallra	22,683,102	28,066,540
	<u>22,683,102</u>	<u>28,066,540</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	87,915,144	100,180,869
	<u>87,915,144</u>	<u>100,180,869</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Tatim fitimi parapaguar	784,176	290,548
	<u>784,176</u>	<u>290,548</u>

ARCHIMED INTERNATIONAL sh.p.k.
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lek)

8. Inventarë

Inventari më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Materiale të para	864,055	5,290,057
Materiale ndihmëse	600	24,870
	<u>864,655</u>	<u>5,314,927</u>

9. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagime dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime të shtyra	6,663,544	1,208,512
Parapagime për furnitorë	150,930	2,128,955
	<u>6,814,474</u>	<u>3,337,467</u>

10. Aktive financiare

Aktive financiare detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Aktive financiare	280,000	-
	<u>280,000</u>	<u>-</u>



ARCHIMED INTERNATIONAL sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

11. Aktive Afatgjata Materiale

Kosto	Instalime		Mjete transporti	Mobilje e pajisje zyre	Pajisje informatike	Te tjera	Totali
	Ndërtesa	Makinieri dhe Pajisje					
Gjendja më 1 janar 2019	306,250	2,868,708	11,838,580	1,081,241	591,107	233,333	16,919,219
Shtesa	-	105,719	-	-	-	-	105,719
Pakësime	-	-	(3,705,000)	-	-	-	(3,705,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	306,250	2,974,427	8,133,580	1,081,241	591,107	233,333	13,319,938
Shtesa	-	13,333	-	-	108,229	-	121,562
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	306,250	2,987,760	8,133,580	1,081,241	699,336	233,333	13,441,500
Amortizimi i akumuluar							
Gjendja më 1 janar 2019	135,659	2,094,918	4,491,626	915,347	442,319	186,867	8,266,736
Amortizimi i vitit	8,528	169,976	196,834	31,637	37,109	9,297	453,381
Pakësime	-	-	(3,511,365)	-	-	-	(3,511,365)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	144,187	2,264,894	1,177,095	946,984	479,428	196,164	5,208,752
Amortizimi i vitit	8,103	142,865	118,271	24,008	41,494	7,435	342,176
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	152,290	2,407,759	1,295,366	970,992	520,922	203,599	5,550,928
Vlera neto kontabël							
Gjendja më 31 dhjetor 2019	162,063	709,533	6,956,485	134,257	111,679	37,169	8,111,186
Gjendja më 31 dhjetor 2020	153,960	580,001	6,838,214	110,249	178,414	29,734	7,890,572

ARCHIMED INTERNATIONAL sh.p.k.
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Furnitorët	2,470,045	15,288,563
	<u>2,470,045</u>	<u>15,288,563</u>

13. Parapagime të arkëtuara

Parapagime të arkëtuara më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Parapagime të arkëtuara	-	1,227,041
	<u>-</u>	<u>1,227,041</u>

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
TVSH për tu arkëtuar	138,814	636,583
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	378,374	389,535
Tatimi mbi të ardhurat	109,398	107,242
Tatimi në burim	6,075	6,075
	<u>632,661</u>	<u>1,139,435</u>

15. Detyrime për qira financiare

Detyrimet për qira financiare detajohen më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Detyrime për qira financiare	2,265,750	2,978,435
	<u>2,265,750</u>	<u>2,978,435</u>

16. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Paga për tu paguar	1,323,396	1,357,980
Detyrime të tjera	5,099	-
	<u>1,328,495</u>	<u>1,357,980</u>

ARCHIMED INTERNATIONAL sh.p.k.
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lek)

17. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 Lek i zotëruar 100% nga ortakut Ardian Asllani.

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Numri i kuotave	100	100
Vlera nominale (në LEK)	1,000	1,000
Kapitali themeltar	<u>100,000</u>	<u>100,000</u>

Shoqëria ka fitime të mbartura më 31 dhjetor 2020 në vlerën 121,132,408 Lek.
 Rezervat statutorë të shoqërisë më 31 dhjetor 2020 janë në vlerën 332,932 Lek.
 Rezervat ligjore të shoqërisë më 31 dhjetor 2020 janë në vlerën 590,532 Lek.
 Rezervat e tjera të shoqërisë më 31 dhjetor 2020 janë në vlerën 930,864 Lek.

18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga ndërtimet	68,954,553	105,054,691
Të ardhura të tjera	50,544	-
	<u>69,005,097</u>	<u>105,054,691</u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	<u>31 dhjetor 2020</u>
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	67,778,056
Shtohen parapagimet në mbyllje	1,227,041
Shuma e qarkullimit e korrektuar	<u>69,005,097</u>
Sipas Kontabilitetit	69,005,097
Diferenca	<u>-</u>

19. Të ardhurat të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzimet nga këmbimet valutore për marrdhëniet tregtare	(1,135)	(22,757)
Të ardhura nga këmbimet valutore për marrdhëniet tregtare	19,343	58,509
Të ardhura nga shitja e aktiveve (neto)	-	806,357
	<u>18,208</u>	<u>842,119</u>

ARCHIMED INTERNATIONAL sh.p.k.
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

20. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Materiale të para	23,649,391	17,635,830
Lëndë djegëse	283,020	697,930
Pjesë ndërrimi	217,034	124,616
Materiale të tjera	69,932	565,531
	<u>24,219,377</u>	<u>19,023,907</u>

21. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzim qeraje	720,000	720,000
Shpenzime transporti	1,256,007	1,758,625
Shërbime nga të tretë	23,061,656	53,746,502
Shërbime bankare	137,909	152,754
Shërbime postare dhe telekomunikimi	353,236	420,845
Taksa dhe tarifa vendore	1,139,787	1,381,916
Të tjera	823,539	5,188,717
	<u>27,492,134</u>	<u>63,369,359</u>

22. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Paga personeli	13,253,174	18,725,741
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	2,159,176	2,992,481
	<u>15,412,350</u>	<u>21,718,222</u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2020 është 24.

ARCHIMED INTERNATIONAL sh.p.k.
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

23. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime amortizimi	342,176	453,381
	<u>342,176</u>	<u>453,381</u>

24. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjokat dhe penaltetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Gjoka dhe dëmshpërblime	551,251	84,922
	<u>551,251</u>	<u>84,922</u>

25. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime të tjera financiare.

Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime financiare të tjera	105,296	133,608
	<u>105,296</u>	<u>133,608</u>

26. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	900,721	1,113,411
Total shpenzime të panjohura	<u>551,251</u>	<u>4,234,882</u>
Shpenzime për pritje përcjellje		
Penalite, gjoka e dëmshpërblime	551,251	84,922
Shpenzime të tjera	-	4,149,960
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	<u>1,451,972</u>	<u>5,348,293</u>
Humbje fiskale e mbartur	-	-
Tatim fitimi 15%	<u>217,796</u>	<u>802,244</u>
	<u>682,925</u>	<u>311,167</u>

27. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme (paradhënie)	Të arkëtueshme	Të pagueshme (paradhënie)
Pitagora Konstruksion	15,391,427	-	27,657,152	(1,227,040)
Archimed 2001	72,523,717	-	72,523,717	-
	87,915,144	-	100,180,869	(1,227,040)

28. Angazhime dhe pasiguri*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2020 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

29. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.